



# Republika e Kosovës

Republika Kosovo / Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Rahovec

Skupština Opštine Orahovac / Municipal Assembly Rahovec

## Komiteti për arsim

### PROCESVERBAL

Mbledhja e Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara, e mbajtur më datë 15.3.2024 (e premte) me fillim në orën 10:00. Mbledhjen e parë e kryesoi anëtari më i vjetër, z. Selman Shtavica, nga gjithsej pesë (5) anëtarë që janë në këtë komitet. Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm në mbledhje.

Për këtë mbledhje, është propozuar ky rend dite:

### REND DITE

1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara;
2. Të ndryshme.

**Kryesuesi:** Përshëndetje për të gjithë anëtarët e komitetit për arsim! Unë jam Selman Shtavica, i zgjedhur anëtar i këtij komiteti. Së pari kërkoj që punën në komitet ta bëjmë me zemër dhe me vepra, e jo vetëm me fjalë.

**Atdhe Rama:** Faleminderit! Padyshim që do të punojmë seriozisht në këtë komitet, do ta krijojmë një plan të punës për mbajtjen e mbledhjeve. Do të mundohemi ta bëjmë më të mirën e mundshme për këtë kategori. Personalisht, e kam vazhën me fibrozë cistike, nuk është me aftësi të kufizuara, por e ka këtë sëmundje të rrallë që dëshiron përkushtim të madh në trajtim.

**Skender Hamza:** Faleminderit, Atdhe! Sa i përket pikës së parë, duhet ta kemi një propozim për kryesues/e dhe për zëvendëskryesues/e.

#### 1. Zgjedhja e kryesuesit të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuara:

**Samra Kërçagu:** Faleminderit! Pas konsultimit, kemi vendosur që për kryesuese ta propozojmë Almedina Jahën dhe zëvendëskryesues, Atdhe Ramën.

**Skender Hamza:** Atëherë, faleminderit! Kryesuesi i vendos në votim propozimet. Kush është “për”?... Me shumicë unanime fillimisht u votua kryesuesja dhe më pas edhe zëvendëskryesuesi.

**Skender Hamza:** Atëherë, ju ftoj që të uleni në vendet tuaja, kryesuese dhe zëvendëskryesues.

**Kryesuesja:** Faleminderit shumë! Personalisht, jam duke punuar me këtë kategori të personave që edhe në këtë komitet do ta kemi si qëllim parësor përmirësimin e gjendjes së tyre, duke iniciuar propozime të ndryshme që ndikojnë direkt në jetën e tyre. Faleminderit edhe një herë!

**Skender Hamza:** Faleminderit shumë! Urime dhe ju shkoftë mbarë!

#### 2. Të ndryshme:

**Kryesuesja:** Atëherë, nëse dikush ka diçka për të thënë në pikën “të ndryshme”? Nëse jo, atëherë mbledhja për sot përfundon dhe shihemi në mbledhjet e radhës.

Mbledhja ka përfunduar në orën 10:20

Procesmbajtësi:

  
Albion Krashiqi

Kryesuesja e mbledhjes:

  
Almedina Jaha

